

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“KRUSHOVA 2020”**

Sot, më datë 28/01/2020, u paraqit personalisht:

- **Z. Rigert Turku**, i datëlindjes 04/11/1981, shtetas shqiptar, lindur dhe banues ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr BI2815379, me cilësinë e ortakut të vetëm të shoqërisë tregtare KRUSHOVA 2020 sh.p.k.

I cili përpilon këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare “KRUSHOVA 2020” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "KRUSHOVA 2020" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “KRUSHOVA 2020” SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2 Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3 Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit “**KRUSHOVA 2020**” SH.P.K dhe me emrin tregtar **KRUSHOVA 2020**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4 Objekti i veprimtarisë**

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

- Kryerjes se servisit universal per te gjitha llojet e automjeteve. Kryerjes te te gjitha sherbimeve te tjera ndihmese te nevojshme qe plotesojne kryerjen e aktivitetit ne fjale.
- Shitjes me pakice te pjeseve te kembimit, gomave, nyjeve, agregateve te automjeteve te te gjitha markave.
- Qiradhenia e automjeteve te te gjitha llojeve, ngritja e rrjetit te qiradhenies se automjeteve ne te gjithe territorin e Shqiperise.

## **NENI 5 Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Tiranë, në adresën: **Rr. “Pjeter Bogdani”, Pallati Nr. 8/1, Kati I, Tiranë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

## **NENI 6 Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njqind mije leke) dhe zotërohet nga ortaku themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: Lekë 100.000 (njqind mije leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaku themelues.

## **NENI 7**

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare “KRUSHOVA 2020” Sh.p.k zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	Rigert TURKU
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesemarrja ne Shoqeri :	100 %
Lloji i kontributit:	ne para
Vlera e kontributit	100,000 (njqind mije) leke;

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendosi qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vonë 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.

Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikur ne kete Statut.

## **NENI 8 Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asamblea e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## **NENI 9 Administratori/ët**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 4 (kater) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jete :

**Z. Rigert Turku**, i datëlindjes 04/11/1981, shtetas shqiptar, lindur dhe banues ne Tirane, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i pasaportes me nr BI2815379.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

#### **NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëmbtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

#### **NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

#### **NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku i Vetëm Themelues, u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se edhe ortaku eshte njohes i gjuhes shqipe.

### **ORTAKU THEMELUES**

**Rigert TURKU**

